


Mbledhja e grupit të punës për të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë jashtë Shqipërisë



U zhvillua mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për të diskutuar rreth hartimit të paketës ligjore që do të garantojë të drejtën e votës në Diasporë. Ky grup ndërinstitucional kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij janë specialistë nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë dhe Instituti i Statistikave. Gjatë mbledhjes, ministri Majko paraqiti sugjerimet e tij lidhur me disa nga modelet që mund t'i përafrohen rastit të Shqipërisë, pasi është e rëndësishme që të merren në shqyrtim të gjitha detajet në hartimin e kësaj pakete. Një material i strukturuar i paketës ligjore do të hartohet dhe do të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave. Ndërkohë grupi i punës vendosi zhvillimin e një mbledhjeje tjetër, brenda pak ditësh, për të paraqitur sugjerimet e secilit anëtar.

Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Fustanella shqiptare në Otranto



Këtë fundjavë, në Otranto të Italisë u mbajt aktiviteti kulturor “Fustanella - Ura lidhëse e Adriatikut”, i organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me “Polo Biblio Museale” të Pulias, “Integra Solidale”, Komunën e Otrantos dhe nën kujdesin e ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky aktivitet etnokulture me Arbëreshët e Italisë, u organizua për herë të parë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, për të diskutuar mbi elementet kulturore, antropologjike, historike e folklorike, me qëllim evidentimin e veçorive dhe të kostumeve tipike popullore, veçanërisht të “Fustanellës”, si dhe kërcimet e bukura tradicionale të zonave ku janë vendosur arbëreshët. Programi i këtij aktiviteti përfshinte një gamë të gjerë aktivitetesh e prezantimesh, duke përfshirë kumtesën e studiuësve nga Shqipëria dhe të përfaqësuesve të komunitetit të “Piana degli Albanesi”, komunitetit arbëresh të Kalabrisë dhe të Bazilikatës dhe të San Marzano di San Giuseppe. U bë prezantimi i veshjeve tradicionale dhe i valleve popullore shqiptare, i zakoneve shqiptare dhe i valleve të arbëreshëve në Itali, si dhe i kostumeve dhe valleve tradicionale të Salentos.



“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



- Për përdoruesit e iOS aplikacioni shkarkohet [këtu](#);
- Për përdoruesit e Android aplikacioni shkarkohet [këtu](#);

QBD / Libri i mësuesit për gjuhën shqipe falas online



Për të mbështetur mësimin e gjuhës shqipe, njihjen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në Diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën ofron falas për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë Librat e mësuesit për Gjuhën Shqipe 2, 3, 4, 5, 6, të cilët mund të shfletohen online ose të shkarkohen në formatin PDF. Në rubrikën “Tekste shkollore”, ku ofrohen tekste shkollore digjitale dhe informacion i dobishëm për tekste të ndryshme shkollore që mund të përdoren për mësimdhënien në Diasporë, është përfshirë edhe nënrubrika “Libra mësuesi”, në të cilën mësuesi mund të klikojë mbi secilën ikonë për të shfletuar ose shkarkuar librin e dëshiruar.

KKD / Adriana Bejko apel për ruajtjen e gjuhës shqipe



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Adriana Fishta-Bejko, i bën apel komunitetit shqiptar në Kanada për ruajtjen e gjuhës shqipe. Sipas saj, po bie interesi ndaj gjuhës shqipe, ndaj shqiptarët në Kanada duhet të ndryshojnë mentalitetin e integritimit. “Duhet të luftojmë për ruajtjen e gjuhës në mënyrë që të ruajmë identitetin tonë në Diasporë”, shkruan ajo.

Publikohet Buletini shtator 2019, për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës



Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Buletini nr. 3 është vazhdim i publikimeve të mëparshme dhe në të jepet një informacion i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit nga institucionet shtetërore përgjegjëse për politikën e Diasporës. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave shtetërore për Diasporën. Institucionet, grupet e interesit, publiku, media dhe qytetarët janë të mirëpritur për propozimet e tyre, të cilat do të shërbejnë për fuqizimin e bashkëpunimit me Diasporën.

KKD / Visar Tasimi kandidon për këshillin bashkiak



Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, Visar Tasimi është një prej kandidatëve për Këshillin Bashkiak në qytetin e Naugatuk në SHBA, një komunitet ku jetojnë rreth 10 mijë shqiptarë. Në një intervistë për gazetën lokale ai tregon arsyet pse vendosi të garojë dhe si e sheh të ardhmen e komunitetit. Zgjedhjet do të zhvillohen më 5 nëntor.

QBD / Vazhdon shpërndarja e teksteve falas në Itali



Shkollat shqipe në Itali vazhdojnë të pajsen me tekstet mësimore të dërguara falas këtë vit nga Qendra e Botimeve të Diasporës. Këshilli Drejtues i Federatës së Shoqatave Shqiptare në Itali “FAAI” është angazhuar për shpërndarjen e abetareve dhe librave për mësim plotësues të gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shqipe në qytete të ndryshme të Italisë.

QBD në Kuvendin European mbi projektin e “Words4link – shkrimtaria e mërgimtarëve për integrimin”



Qendra e Botimeve për Diasporën merr pjesë në Kuvendin European të shkëmbimit të përvojave të mira mbi projektin e “Words4link - shkrimtaria e mërgimtarëve për integrimin”, një projekt i rëndësishëm ky pjesë e të cilit do të jenë shkrimtarët shqiptarë në emigracion dhe QBD-ja. Ky projekt i financuar nga Komuniteti European synon të bashkojë në një rrjet të përbashkët shkrimtarë emigrantë të vendeve të ndryshme që shkruajnë në gjuhën italiane. Projekti synon t'i japë zë letërsisë së migracionit, veprave të tyre dhe shkëmbimit të përvojave. Në rrjetin e krijuar nga projekti bëjnë pjesë dhe shumë shkrimtarë shqiptarë që shkruajnë në gjuhën italiane.